



INSTITUTI AAB
PËR KONTABILIST DHE AUDITOR TË CERTIFIKUAR

NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E BESIMIT NË SISTEMIN TATIMOR PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME



DHJETOR 2024

NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E BESIMIT NË SISTEMIN TATIMOR PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME



BOTUES © Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar

Rruga Elez Berisha, Nr.56 Prishtinë, Zona Industriale Prishtinë – Fushë-Kosovë, 10.000, Kosovë

Tel: +383 48 999 073 & +383 48 999 133

Faqja e internetit: www.institutiaab.org

Adresa elektronike: info@isntitutiaab.org

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.	6
Përmbledhje Ekzekutive.	7
Hyrje.	8
Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	9
Kosova dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	11
Tatimet dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm.	12
Përfundimet	19





Lista e shkurtesave

Instituti AAB	Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar
OZHQ	Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm
OKB	Organizata e Kombëve të Bashkuara
SDG	Sustainable Development Goals

Përmbledhje Ekzekutive

Ky studim analizon rëndësinë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së besimit në sistemin tatimor si një faktor kritik për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të qëndrueshëm. Ai shqyrton mënyrat se si qeveritë mund të forcojnë transparencën, drejtësinë dhe efikasitetin e sistemit tatimor për të rritur përmbushjen e detyrimeve tatimore nga qytetarët dhe bizneset, duke kontribuar në stabilitetin ekonomik dhe shoqëror.

Hulumtimi bazohet në një anketë të kryer në Kosovë, e cila përfshiu 150 pjesëmarrës nga fusha të ndryshme si kontabiliteti, auditimi dhe biznesi. Gjetjet kryesore përfshijnë:

- o Pjesëmarrësit e anketës, e cila përfshiu 150 profesionistë nga fusha të ndryshme si kontabiliteti, auditimi dhe biznesi, identifikuan transparencën dhe zvogëlimin e korrupsionit si faktorë kryesorë për rritjen e besueshmërisë së sistemit tatimor. Sipas anketës, 54.9% e pjesëmarrësve besojnë se përmirësimi i transparencës dhe informimit të tatimpaguesve është çelësi për të forcuar besimin, ndërsa 41.2% e konsiderojnë të rëndësishme zvogëlimin e evazionit tatimor dhe korrupsionit.

- o Sistemet tatimore mund të jenë një mjet i fuqishëm për financimin dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Përmes politikave fiskale të orientuara, qeveritë mund të ndikojnë në sjelljen e bizneseve dhe qytetarëve, duke promovuar modele të përgjegjshme konsumimi dhe prodhimi. Rreth 70% e pjesëmarrësve në studim theksojnë rëndësinë e lidhjes së sistemit tatimor me zhvillimin e qëndrueshëm, megjithëse shumë prej tyre shprehën skepticizëm për efektivitetin aktual të tatimeve.

- o Perceptimi i lartë për korrupsionin dhe drejtësinë e ulët të sistemit tatimor janë faktorë që pengojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore. Pothuajse gjysma e pjesëmarrësve u shprehën se nuk janë të gatshëm të paguajnë tatime shtesë për të mbështetur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke nënvizuar nevojën për përmirësimin e besimit dhe llogaridhënies.

- o Ndërsa kontabilistët dhe auditorët e certifikuar gëzojnë nivele të larta besimi, autoritetet tatimore dhe institucionet e tjera kanë një besueshmëri më të ulët. Ky dallim nënvizon nevojën për reforma që synojnë rritjen e integritetit institucional.

Si përfundim studimi konfirmon se një sistem tatimor i drejtë, transparent dhe i besueshëm është kritik për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Përmes reformave dhe angazhimit të palëve të interesit, institucionet tatimore mund të krijojnë një mjedis më të qëndrueshëm dhe të favorshëm për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies sociale në Kosovë. Një përfaqje gjithëpërfshirëse dhe e bashkërenduar është e domosdoshme për të adresuar sfidat aktuale dhe për të ndërtuar një të ardhme që garanton prosperitet për të gjithë qytetarët.

Dhe rekomandimet e daluara nga ky studim janë:

- o Institucionet tatimore duhet të fokusohen në ofrimin e informacioneve të qarta dhe transparente për tatimpaguesit, duke adresuar perceptimin e korrupsionit dhe pabarazisë.

- o Qeveritë duhet të zhvillojnë politika tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik, ruajnë mjedisin dhe përmirësojnë barazinë sociale. Kjo përfshin përdorimin e stimujve fiskalë për të promovuar investime të qëndrueshme dhe vendosjen e taksave që ndalojnë praktikën e dëmshme.

- o Nxitja e edukimit tatimor dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse është thelbësore për rritjen e përbushjes së detyrimeve tatimore dhe uljen e evazionit.

- o Rritja e bashkëpunimit me profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit për të forcuar standardet profesionale dhe për të ndihmuar në adresimin e sfidave komplekse tatimore.

- o Institucionet në Kosovë duhet të integrojnë qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e mjedisit në axhendat e tyre, duke ndërtuar partneritete gjithëpërfshirëse për të siguruar ndikim të prekshëm për qytetarët.

Përmes këtij punimi, synohet të pasqyrohet një analizë e thelluar dhe kritike mbi rolin e tatimeve në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke hedhur dritë mbi sfidat, mundësitë dhe implikimet e politikave tatimore në të ardhmen e qëndrueshme të shoqërive moderne.

Studimi trajton rëndësinë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së besimit në sistemin tatimor si një element thelbësor për një të ardhme të qëndrueshme ekonomike dhe sociale.

Gjithashtu, theksohet rëndësia e edukimit tatimor dhe angazhimit të qytetarëve për të përballuar sfidat e ardhshme ekonomike me përgjegjësi dhe qëndrueshmëri.

Ky studim është bazuar në një anketë online, e cila është kryer në periudhën shtator-tetor 2024, me rreth 150 respondentë, të cilët përfaqësojnë profesionist të fushës së kontabilitetit, auditimit, tatimeve, si dhe përfaqësues të biznesit. Pyetësi është shpërndarë te përfaqësues të ndryshëm të fushës së tatimeve dhe financave, duke përfshirë kontabilistë, auditorë dhe pronarë biznesesh, me një përhapje gjeografike që mbulon gjithë territorin e Kosovës dhe siguron një përfaqësim të balancuar të pjesëmarrësve.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Gjatë viteve të fundit, një vëmendje e madhe po i kushtohet konceptit të qëndrueshmërisë. Qëndrueshmëria përkufizohet nga Komisioni Brundtland i Kombeve të Bashkuara si "plotësimi i nevojave të së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre". Edhe pse qëndrueshmëria shoqërohet shpesh nga shumica e njerëzve me ruajtjen e mjedisit, ajo në fakt përfshin shumë dimensione veçanërisht nëse flasim për zhvillim të qëndrueshëm.

Zhvillimi i qëndrueshëm pranon se shëndeti mjedisor dhe barazia sociale duhet të merren parasysh me vetëdije së bashku me zhvillimin ekonomik nëse synojmë prosperitet që nuk do të ndikojë negativisht në brezat e ardhshëm. Në vitin 2015, të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara miratuan Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e cila parashikon 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe 169 objektiva që mbulojnë dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore të zhvillimit të qëndrueshëm.

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) janë: (1) pa varfëri, (2) zero uri, (3) shëndet dhe mirëqenie të mirë, (4) arsim cilësor, (5) barazi gjinore, (6) ujë të pastër dhe kanalizime, (7) energji të përbalueshme dhe të pastër, (8) punë të denjë dhe rritje ekonomike, (9) industri, inovacion dhe infrastrukturë, (10) reduktim të pabarazive, (11) qytete dhe komunitete të qëndrueshme, (12) konsum dhe prodhim të përgjegjshëm, (13) veprim klimatik, (14) jeta nën ujë, (15) jeta në tokë, (16) paqja, drejtësia dhe institucionet e forta, (17) partneritetet për objektivat.



Ndonëse dhënia e stimujve tatimorë sigurisht që do të inkurajojë bizneset të investojnë në projekte të qëndrueshme, ajo duhet të studiohet gjithmonë tërësisht pasi kjo do të rezultojë në të ardhura tatimore të papaguara për qeverinë, të cilat përndryshe mund të përdoren për të mbështetur SDG të tjera. Në vend të dhënies së stimujve tatimorë, rregulloret tatimore mund të vendosin gjithashtu gjyba ose taksa shtesë për produktet ose sjelljet që mund të jenë të dëmshme për mjedisin ose shëndetin e njeriut, të cilat paraqesin sfida në arritjen e SDG-ve.

Kosova dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në mënyrë vullnetare në janar 2018 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një rezolutë ku edhe Kosova i bashkohet Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pavarësisht se nuk e ka nënshkruar këtë dokument duke pasur parasysh statusin e saj si jo anëtare e OKB-së. Por me këtë vendim Kosova i bashkohet vullnetarisht përpjekjeve globale lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm, dhe në këtë mënyrë nxit akterë të ndryshëm për të mobilizuar përpjekjet për ta luftuar varfërinë, promovuar rritjen ekonomike dhe për t'i zvogëluar pabarazitë.

Si kudo në botë, edhe qytetarët e Kosovës nga rezultatet e arritura të kësaj agjende përfitojnë shërbime më të mira publike, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme dhe në mirëqenien e tyre si dhe duke kontribuar gjithashtu në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet qeverisëse si lokale dhe ato qendrore. Të gjitha institucionet në Kosovë duhet të jenë të shtyra për të vendosur zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit në agjendat e tyre, me qëllim të arritjes së ndryshimeve pozitive në terren dhe të prekshme për qytetarët.

Disa nga aktivitetet që ishte dashtë të përfshijnë në agjendat e tyre përfshijnë ndërgjegjësimin, shkëmbimin e informatave të nevojshme dhe me rëndësi për këto objektiva, si dhe eksplorimin e pengesave dhe mundësive për një rrugë të qëndrueshme përpara.



Përmes këtyre aktiviteteve dhe zhvillimit të një dialogu gjithëpërfshirës me publikun do të shijojnë drejt mënyrave më efektive për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm nga njëra anë, dhe një ekonomi të gjelbër dhe gjithëpërfshirëse deri në vitin 2030 nga ana tjetër.

Tatimet dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

Ndryshimi i klimës është padyshim rreziku më i madh me të cilin përballet bota jonë sot. Nëse qeveritë do të përballen me sfidat e ngrohjes globale, sistemet e tatimeve do të kenë një rol jetik për të luajtur.

Ndërsa gjithnjë e më shumë qeveri lëvizin drejt angazhimeve Net Zero, kostot e ndryshimeve të infrastrukturës do të duhet të plotësohen dhe tatimet do të duhet të financojnë pjesën më të madhe të tyre.

Por ka më shumë që tatimet mund të bëjnë. Përveç rritjes së të ardhurave, tatimet mund të drejtojnë sjelljen – dhe e kanë bërë këtë për breza të tërë, pavarësisht nëse janë krijuar për këtë apo jo.

Lidhja midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe tatimeve nuk kufizohet në atë që tatojmë: mënyra se si tatiojmë mund të jetë po aq e rëndësishme dhe shumë më e lehtë për t'u trajtuar në afat të shkurtër.

Rritja e moralit tatimor do të shkojë paralelisht me zvogëlimin e boshllëqeve tatimore (diferenca midis tatimeve që duhet të paguhen dhe tatimeve të mbledhura në të vërtetë).


Tatimimi është një mjet i fuqishëm për të ndihmuar në financimin e arritjeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve; ang. SDG), dhe gjithashtu mund të nxisë zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në mënyra të tjera. Politikat fiskale mund të mobilizojnë njëkohësisht burimet, të zvogëlojnë pabarazitë dhe të promovojnë modele të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

OZHQ-të/SDG-të pranojnë, ndër të tjera, se dhënia fund e varfërisë duhet të shkojë paralelisht me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, reduktojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike. Të gjitha këto objektiva kërkojnë fonde nga burime të ndryshme – tatimet janë një nga më të qëndrueshmet.



Si institut profesional në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, jemi krenarë që shohim nivele të larta të qëndrueshme të besimit tek kontabilistët profesionistë. Ne mezi presim të vazhdojmë të angazhohemi me palët kryesore të interesit për të nxitur besimin në tatime dhe besimin në profesionin tonë - të gjitha në interes të publikut. Tani, më shumë se kurrë, marrëdhënia midis tatimpaguesve dhe qeverive, dhe midis bizneseve, shoqërisë dhe sistemeve tatimore, është thelbësore për mbijetesën e ekonomive që na mbështesin të gjithëve në terma afatshkurtër dhe afatgjatë.

Grafikoni 1. Besimi në sistemin tatimor në shoqërinë tonë



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Sipas grafikoni 1. 54.9 % e pjesëmarrësve mendojnë se besueshmeria në sistemin tatimor mund të rritet përmes përmirësimit të transparencës dhe informacioneve për tatimpaguesit. Ndërsa 41.2 % e pjesëmarrësve mendojnë se besueshmeria në sistemin tatimor mund të rritet nëse zvogëlohet evazioni tatimor dhe niveli i korrupsionit në administratën tatimore.


Grafikoni 2. Ndërtimi i besimit në sistemin tatimor si kontribues në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe shoqërisë



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Në grafikoni 2. Pothujase të gjithë respondentët mendojnë se transparenca dhe besimi në sistemin tatimor kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe shoqërisë, përkatësisht janë thelbësore për stabilitet ekonomik të vendit.


Grafikoni 3. Besueshmëria në sistemin tatimor në Kosovë



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Në pyetjen se sa e besojnë sistemin tatimor qytetarët, diagrami 3 paraqet një ndarje të përafërt të të anketuarëve sa i përket besueshmërisë së sistemit tatimor dhe drejtësisë për të gjithë qytetarët.


Grafikoni 4. Niveli i besueshmërisë tek profesionistët dhe institucionet për çështje tatimore



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Në grafikonin 4. pasqyrohet besimi i publikut te profesionistët e fushës së kontabilitetit, auditimit, tatimeve dhe institucioneve ne lidhje me çështjet tatimore. Rezultatet shfaqin një besueshmëri bukur të lartë për kontabilistët dhe auditorët e certifikuar, një besueshmëri neutrale për autoritetet tatimore, ndërsa besueshmeria ulet te kategoritë tjera si avokatët që merren me çështje financiare/tatimore, OJQ-të, odat ekonomike ose asociacionet e biznesit, si dhe mediat

Grafikoni 5. Rëndësia e mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimi i mirëqenies sociale nga kompanitë/institucionet me praktika që ndikojnë në rritjen ekonomike afatgjatë



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Në pyetjen e 13 të pyetësit respondentët kishin mundësi të përzgjidhnin një nga pesë opsione (nga aspak – në shumë e rëndësishme). Grafikoni 5 tregon se shumica e pjesëmarrësve mendojnë se është shumë e rëndësishme që kompanitë dhe institucionet të ndjekin praktika të zhvillimit të qëndrueshëm që mbrojnë mjedisin, përmirësojnë mirëqenien sociale dhe sigurojnë rritje ekonomike afatgjatë për vendin tonë.


Grafikoni 6. Lidhshmëria e tatimeve me zhvillimin e qëndrueshëm



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Në grafikun 6. 70% e pjesëmarrësve në hulumtim theksojnë se ekziston një lidhje e fortë dhe se është shumë e rëndësishme që zhvillimi i qëndrueshëm të mbështetet në tatime. Në bazë të kësaj shihet se duhet të ekzistojë një fokus në strategjinë tatimore të vendit.


Grafikoni 7. Gatishmëria e qytetarëve për të paguar tatim shtesë për të mbështetur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Edhe pse në grafikun 6. shihet se ekziston një perceptim se zhvillimi i qëndrueshëm duhet të mbështetet në tatime, në grafikun 7. vërejmë se pothuajse gjysma e të anektuarëve nuk kanë një mendim të qartë se a janë të gatshëm për të paguar një tatim shtesë për të mbështetur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Nga ndërlidhja e përgjigjeve konstatojmë se shumica mendojnë se tatimet duhet të jenë më transparente dhe se duhet të rritet besueshmëria në sistemin tatimor në mënyrë që të jetë efektiv për të arritur objektivat.

Grafikoni 8. Ndikimi i korrupsionit në moskryerjen e obligimeve tatimore ndaj shtetit



(Burimi: Të dhënat primare nga pyetësi)

Grafikoni 8. Na tregon se pothuajse gjysma e respondentëve gjithashtu mendojnë se perceptimi ndaj korrupsionit ndikon në pagesat e detyrimeve tatimore dhe nga kjo mund të vërehet se përse nuk janë të gatshëm të paguajnë tatime shtesë për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Përfundim

Hulumtimi ynë tregoi se një sistem tatimor i besueshëm dhe transparent është kritik për rritjen ekonomike dhe mbështetjen e politikave të qëndrueshme sociale dhe mjedisore.

Për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, është e rëndësishme që politikat tatimore të jenë të orientuara drejt të ardhurave të qëndrueshme dhe të përdoren strategjitë e drejtimit të tatimeve për të inkurajuar rritjen ekonomike dhe për të adresuar sfidat e përbashkëta shoqërore dhe mjedisore.

Në fund, kjo analizë përpiqet të ofrojë një kontribut në kuptimin e thellë të ndërveprimit midis tatimeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke identifikuar sfidat aktuale dhe rekomandimet për politika të mëtejshme. Sfidat e ardhshme do të kërkojnë vazhdimisht përmirësimin dhe rritjen e besimit në sistemin tatimor për të siguruar një rrugë të qëndrueshme drejt përparimit dhe mirëqenies së përgjithshme shoqërore.

Rreth Institutit AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar

Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar është themeluar me 15.01.2016 dhe është licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF). Instituti AAB synon që të mbroj interesin publik duke siguruar që anëtarët e saj respektojnë standardet më të larta të sjelljes profesionale dhe etike, që studentët e Institutit të fitojnë njohuritë, aftësitë dhe vlerat që ata të bëhen anëtarë të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, si dhe t'i ruajnë dhe t'i zhvillojnë ato njohuri, aftësi dhe vlera gjatë gjithë karrierës së tyre profesionale. Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditor të Certifikuar tashmë është akredituar edhe Autoriteti Kombëtar i Kualifikimve të Republikës së Kosovës.

Që nga viti 2024 IAAB është anëtar me të drejta të plota në Federatën Mesdhetare të Kontabilistëve, me seli në Paris, Francë.





INSTITUTE **AAB**